



**KUOTIMI I ÇMIMEVE  
PROKURIMI ME VLERË MINIMALE**

*Sipas Nenit 37 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Data e Ftesës: 24.09.2019

Numri i Prokurimit	320	19	056	247
--------------------	-----	----	-----	-----

**NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtar: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	
Adresa e AK: Rr. Migjeni nr. 21	
Qyteti: Prishtinë	Kodi Postar: 10000
Personi kontaktues: Visar Kastrati	e-mail: prokurimi.kqz@kqz-ks.org
Telefoni: 038 200 81 006	Faksi:

**NENI II: IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)**

Emri i OE: Saba Tours Sh.p.k	Personi kontaktues: Driton Bytyqi
Adresa: Bulevardi Bill Clinton Nr 136	Telefoni: +383 44 390 571
Qyteti: Prishtinë	Faksi:
Kodi Postar: 10 000	E-mail: info@sabagroup.eu

**NENI III: TË DHËNAT NË LISTEN E ÇMIMEVE**

**III.1) TITULLI I PROKURIMIT**

Program njoftues për vëzhguesit ndërkombëtar për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019

**III.1.1) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 60-000000-8**

**III.2)** Në mënyrë që të dëshmohet se Operatori Ekonomik (OE) është i përshtatshëm që të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, OE duhet të nënshkruaj dhe të paraqes me kuotimin e tij Deklaratën nën Betim të bashkangjitur.

**III.3) PËRSHKRIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS:**

*Objekti i kontratës.*

**Specifikat teknike për Mbajtja e programit njoftues për vëzhguesit ndërkombëtar për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës – 2019**

**1. INFORMATAT THEMELORE**

Ky dokument është përgatitur me qëllim të realizimit të aktivitetit të planifikuar Mbajtja e programit njoftues për vëzhguesit ndërkombëtar për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës – 2019.

Proceset zgjedhore në Kosovë në vazhdimësi ka pasur vlerësime pozitive dhe shërbimet e ofruara nga KQZ kanë pasur një trend pozitiv të zhvillimit. Vëzhgimi profesional dhe serioz dhe ndërkombëtar i zgjedhjeve ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e integritetit të zgjedhjeve por edhe identifikimin e mungesave të cilat i kanë shërbyer KQZ-së për të pasur përmirësim të vazhdueshëm duke arritur me sukses standardet ndërkombëtare dhe zbatimin e praktikave të mira.

Përveç rolit të rëndësishëm të vëzhguesve për përmirësimin e procesit zgjedhor, ata mund të shërbejnë fuqishëm edhe në procesin e lobimit për Kosovën në arenën ndërkombëtare si në aspekt të shtetësisë ashtu edhe në promovimin e atraksioneve, historike, kulturore dhe turistike që ka Kosova.

Specifikimet teknike që janë të cekura në këtë dokument janë korniza e nevojshme për të arritur zbatimin me sukses të këtij aktiviteti dhe realizimi i objektivave të tij. Të njëjtat specifika duhet të zbatohen nga kompanitë ofertuese. Kompanitë janë të obliguar që tu përmbahen të gjitha kërkesave teknike, sigurisë, dhe afateve kohore.

## **2. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PROGRAMIN NJËDITOR**

Për mbajtjen e programit njoftues për vëzhguesit ndërkombëtar për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës – 2019 janë të nevojshme shërbimet si në vijim:

- a) Transporti me autobus të kualitetit VIP
- b) Ciceron profesional
- c) Program historik dhe kulturor
- d) Program kulinar

### **Transporti me autobus të kualitetit VIP**

Autobusët e ofruar nga kompania për datën 5 tetor 2019, do të jenë modern dhe cilësorë duke përfshirë:

- a) Klimatizim të plotë
- b) Shërbime zërimi (mikrofon)
- c) Me të paktën 50 ulëse
- d) Ulëset të jenë me rripa sigurie (e rekomandueshme)
- e) Shofer profesional

### **Ciceron profesional**

Ciceroni duhet të jetë profesional (rekomandohet i certifikuar) dhe duhet të ketë kualitetet si në vijim:

- a) Të flas gjuhën angleze rrjedhshëm
- b) Të ofroj prezantimet në gjuhën angleze
- c) Të jetë njohës i mirë i historisë, kulturës dhe atraksioneve turistike të Kosovës
- d) Të jetë në gjendje të jep përgjigje në pyetjet e pjesëmarrësve

### **Programi Historik dhe Kulturor**

Programi i ofruar nga kompania duhet të përfshijë të paktën prezantim dhe mbuloj shpenzimet e mundshme të hyrjes për:

- a) Vizitë në qytetin antik të Ulpianës
- b) Vizitë në manastirin e Deçanit
- c) Vizitë në Xhamin e Sinan Pashës në Prizren
- d) Vizitë në kalanë e Prizrenit





e) Vizitë në Lidhjen e Prizrenit

### Programi Kulinar

Programi i ofruar nga kompania duhet të përfshijë të paktën shpjegim dhe mbuloj shpenzimet për:

- a) Ushqim tradicional kosovar
- b) Pije tradicionale kosovare
- c) Desert tradicional Kosovar

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (duke përfshirë të gjitha taksat etj.)	Çmimi Total - €
1	Autobus me shofer (Autobus VIP me 50+ ulëse)	cope	1	400€	400.00€
2	Ciceron profesional (Ciceron qe flet rrejdshëm gjuhen angleze)	person	1	100€	100.00€
3	Programi Historik dhe Kulturor (Vizite ne 5 lokacione)	copë	1	105€	105.00€
4	Programi Kulinar (Ushqim, pije, desert)	shujtë	50	7€	350.00€
<b>Totali i PËRGJITHSHËM</b>					<b>955.00€</b>

Nënshkrimi i zyrtarit te prokurimit të AK-së	Nënshkrimi i përfaqësuesit të OE-së
Emri dhe Mbiemri: <i>Visar Kastrati</i>	Emri dhe Mbiemri: <i>Driton Bytyqi</i>
Nënshkrimi: 	Nënshkrimi: 
Data: <i>30.09.2019</i>	Data: <i>24.09.2019</i>
Vula: 	Vula: 

## DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: ~~[operatorin ekonomik që dorëzon ofertën]~~ deklaroj nën betim se unë jam i përshtatshëm sipas nenin 65, të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në nenin 65 të LPP dhe vërtetoj sei përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë me qëllim apo për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
<b>Emri i OE:</b>	Sana Tours Sh.p.k
<b>Adresa e plotë:</b>	Adresa: Bulevardi Bill Clinton Nr 136
<b>Përfaqësuar nga:</b>	
<b>Emri</b>	Driton Bytyqi
<b>Pozita</b>	CEO
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Data</b>	24.09.2019
<b>Vula</b>	



### Kërkesat e Përshtatshmërisë

(Sipas nenit 65 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092)

1. **Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij:**
  - a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;
  - b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjese të këtyre të fundit; ose
  - c. duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi. siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75.
  
2. **Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara:**
  - a. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprë penale duke përfshirë praktikumin e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-senën ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
  - b. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionalee konstatuar nga një gjykatë kompetente;
  - c. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme;
  - d. është dënuar nga një gjykatë kompetente për veprë penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
  - e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
  - f. është konstatuar nga ndonjë gjykatë kompetente se ka bërë keqëprezantim të ndonjë autoritet publik në Kosovë apo gjetiu.
  
3. **Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik:**
  - a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent; apo aktualisht është objekt procedure (i) për deklarim të falimentimit, (ii) për një urdhër të mbylljes së dhunshme ose administrimi nga një gjykatë, apo (iii) për ndonjë procedurë të ngjashme sipas Ligjit të Kosovës apo ndonjë juridiksioni tjetër;
  - b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
  - c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
  - d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b ose ctë këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
  - e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga operatori ose për atë operatori ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjeseshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij;
  - f. aktualisht është objekt i një vendimi gjyqësor ose procedure administrative që suspendon ose redukton pagesat nga operatori ekonomik ose për operatorin ekonomik; nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
  - g. gjatë (3) tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë entitet publik, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë apo diku tjetër;
  - h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar te jete jo i rëndësishëm ne Kosove;
  - i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
  - j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës;
  - k. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënie të një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes; ose
  - l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.